


Aksidentet Rrugore

Nëntor 2022

Tiranë, më 19 Dhjetor 2022: Në muajin Nëntor 2022 numërohen 92 aksidente rrugore nga 106 të ndodhura në muajin Nëntor 2021. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 13,2 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore dhe të aksidentuarit (të vrarë e të plagosur), Nëntor 2018 – Nëntor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) rezulton 117 persona nga 156 në muajin Nëntor 2021.

Aksidentet rrugore, në 80,4 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç, duke zënë 27,2 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Numri i aksidenteve rrugore për këtë grup-moshë është i njëjtë me numrin e aksidenteve rrugore në Nëntor 2021.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, numërohen 1.060 aksidente rrugore nga 1.257 aksidente, të ndodhura në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 15,7 %.

Numri i të aksidentuarve është 1.479 persona nga 1.726 persona të aksidentuar në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021.

Aksidentet rrugore, në 13,7 % të rasteve, në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022 kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur me 24,9 %.

Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë

Periudha	Aksidente	Të vdekur dhe të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Nëntor 2021	106	52	104
Nëntor 2022	92	36	81
Ndryshimi vjetor (%)	-13,2	-30,8	-22,1
Janar-Nëntor 2021	1.257	543	1.183
Janar-Nëntor 2022	1.060	479	1.000
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-15,7	-11,8	-15,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidentet sipas		Të vdekur dhe të plagosur	
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Nëntor 2021	91	15	141	15
Nëntor 2022	74	18	98	19
Ndryshimi vjetor (%)	-18,7	20,0	-30,5	26,7
Janar-Nëntor 2021	1.064	193	1.523	203
Janar-Nëntor 2022	915	145	1.325	154
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-14,0	-24,9	-13,0	-24,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Nëntor 2021	21	25	17	24	10	9
Nëntor 2022	17	25	15	17	12	6
Ndryshimi vjetor (%)	-19,0	0,0	-11,8	-29,2	20,0	-33,3
Janar-Nëntor 2021	271	341	226	226	118	75
Janar-Nëntor 2022	199	292	200	202	113	54
Ndryshimi vjetor progresiv %	-26,6	-14,4	-11,5	-10,6	-4,2	-28,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rrugore dhe numri i të vdekurve sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur		Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Nëntor 2021	Nëntor 2022	Nëntor 2021	Nëntor 2022	Janar-Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2022	Janar-Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2022
Shqipëria	106	92	156	117	1.257	1.060	1.726	1.479
Berat	3	1	4	1	28	26	42	38
Dibër	1	0	2	0	20	6	28	9
Durrës	9	10	16	14	105	71	163	120
Elbasan	1	3	1	4	53	34	64	41
Fier	9	3	10	3	109	62	156	86
Gjirokastrë	7	6	13	12	80	73	109	124
Korçë	3	8	4	8	53	52	58	70
Kukës	6	3	13	6	47	48	70	74
Lezhë	11	7	17	16	159	136	271	231
Shkodër	2	0	3	0	23	23	30	34
Tiranë	54	48	73	49	563	490	702	596
Vlorë	0	3	0	4	17	39	33	56

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore,

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme,

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë,

I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet,

I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje,

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj,

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj,

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit,

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi, Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#),

Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (,,,) mungesë të dhënash